

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit F. G., nga Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit F. G., N. Q. avokat nga Prizreni, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren KP.nr.95/2015 datë 16.10.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1404/2015 datë 11.1.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30 mars 2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit F. G., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, KP.nr.95/2015 datë 16.10.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1404/2015 datë 11.1.2016.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, KP.nr.95/2015 datë 16.10.2015, është revokuar dënimi me kusht me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve, i shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1157/2013 datë 25.4.2014, ndaj të dënuarit Fadil Gashi njashtu që ky dënim do të ekzekutohet.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1404/2015 datë 11.1.2016.

Kundër këtyre aktgjytimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F. G., N. Q. avokat nga Prizreni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën, KMLP.II.nr.40/2016 datë 7.3.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitave të nenit 425 par.1 dhe 426 par.1 dhe KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit pretendohet se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 3 dhe par.2 të KPPK, si dhe dispozita e nenit 55 të KPK, për faktin se të dënuarit nuk i'u është mundësuar e drejta në mbrojtje, se nga gjykata e shkallës së parë nuk iu janë sqaruar të drejtat e tija në procedurë si dhe pasoja në rast të revokimit të dënimit të kushtëzuar, se i dënuari ka qenë në kontakte të vazhdueshme me të dëmtuarit të cilët kanë negociuar për kushtet e përmbushjes së detyrimeve që dalin nga dënimi i kushtëzuar, se pas aktgjykimit, C.nr.719/2014 i datës 17.9.2015, palët kanë arritur marrëveshje për përmbushjen e detyrimeve, por siç theksohet në kërkesë me fajin e të dëmtuarve nuk është përmbushur detyrimi sipas aktgjykimit të shkallës së parë.

Po ashtu, pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se nuk kanë ekzistuar rrethana për revokimin e dënimit të kushtëzuar. Kërkesës ia bashkëngjit procesverbalin e datës 19.2.2016, nga përmbaruesi privat si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.719/2014 datë 17.9.2015.

Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit të theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk qëndrojnë, për faktin se nga shkresat e çështjes me pa mëdyshje është vërtetuar se i dënuari F. G. është shpallur fajtor për dy vepra penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 të KPK, se me 10.6.2011, ngase në zyrën e avokatit Y. K. e mashtron të dëmtuarin D. K. duke u paraqitur si

pronar i banesës në kompleksin banesor “.....”, në sipërfaqe prej ....., edhe pse kjo banesë është në pronësinë e kompanisë “.....”, nga Prishtina, me ç’rast lidhë kontratë mbi shitblerjen e banesës duke i bërë pagesën në shumë prej 55.000,00 €, të dënuarit përmes transaksionit bankar për “.....”, me ç’rast i pandehuri i premtun të dëmtuarit se banesën në fjalë do t’ia dorëzojë në shfrytëzim të lirë pas pranimit teknik nga Drejtorati për Urbanizëm në Prizren, ndërsa këto detyrime i dënuari ende nuk i ka plotësuar.

Po ashtu, nga aktgjykimi i shkallës së parë vërtetohet se me 13.7.2012, në zyrën e avokatit Y. K., e mashtron edhe të dëmtuarin R. S. në atë mënyrë që lidhë kontratë për shitblerjen e banesës e cila gjendet në kompleksin banesor “.....”, në sipërfaqe prej ....., për çmimin prej 67.757,00 €, ku shumën prej 64.757,00 €, e bënë përmes transaksionit bankar ndërsa shumën prej 3.000 €, i bënë pagesën në mjete të gatshme me ç’rast ka qenë i detyruar që gjer më 1.9.2012, banesën në fjalë t’ia dorëzojë të dëmtuarit në posedim të lirë, të cilën banesë ende nuk ia ka dorëzuar, ndërsa të hollat të dëmtuarve nuk u ka kthyer.

Nuk janë kontestuese rrethanat se sipas aktgjykimit të shkallës së parë i dënuari ka qenë i detyruar që këto detyrime t’i përmbushë në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit- duke e bërë kthimin e përfitimit pasuror të kundërligjshëm. Po ashtu, nuk janë kontestuese rrethanat se i dënuari pranë gjykatës së shkallës së parë ka bërë pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e akuzës për çka gjykata aprovon pranimin e fajësisë dhe vendos si në aktgjykimin e kundërshtuar.

Po ashtu, nga shkresat e çështjes me pa mëdyshje vërtetohet se meqë i dënuari nuk ka përmbushur detyrimet sipas aktgjykimeve të kundërshtuara konform dispozitës së nenit 519 të KPPK, është hapur procedura e revokimit të dënimit të kushtëzuar meqë është caktuar seanca e kolegjit, është njoftuar Prokurori i Shtetit, i dënuari dhe të dëmtuarit me ç’rast në procesverbalin e datës 23.12.2014, i dënuari ka shpjeguar arsyet e mospërmbushjes së detyrimeve sipas aktgjykimit të kundërshtuar, janë përpiluar deklarata në mes të dënuarit dhe të dëmtuarve mirëpo edhe përkundër faktit se koha ka qenë e caktuar që i dënuari t’i përmbushë detyrimet sipas aktgjykimeve të kundërshtuara edhe tani nuk janë përmbushur.

Po ashtu, sipas aktgjykimit KP.nr.4/2015 datë 19.1.2015, të dënuarit iu është caktuar afati i ri për përmbushjen e kushtit të kompensimit të dëmit të shkaktuar të dënuarve, i përcaktuar sipas aktgjykimit P.nr.1157/2013 datë 25.4.2014, ashtu që D. K. t’ia kompensojë shumën e të

hollave prej 55.000 €, kurse të dëmtuarit I. I. shumë prej 67.757,00 €, më së largu gjer më 01.05.2015, duke i lënë në mundësi që të dëmtuarit përmes përfaqësuesve të tyre ta njoftojnë gjykatën për përmbushjen e detyrimit nga ana e të dënuarit, edhe përkundër caktimit të afateve, këto detyrime nuk janë përmbushur për çka gjykata sipas aktgjykimit, KP.nr.95/2015 të datës 16.10.2015, bënë revokimin e dënimit me kusht njashtu që dënimi i shqiptuar sipas aktgjykimit të shkallës së parë duhet ekzekutuar.

Po ashtu, pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se i dënuari nuk ka qenë i udhëzuar mbi të drejtat e tija në procedurë nuk qëndron për faktin se sipas procesverbalit të datës 05.02.2014 dhe 25.04.2015, i dënuari ka qenë i udhëzuar për mundësinë e mbrojtjes në heshtje, të mos u përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga gjykata, të mos inkriminojë veten apo anëtarët e ngushtë të familjes, në të drejtën e kundërshtimit të propozimeve nga akuza si dhe në të drejtën e angazhimit të mbrojtësit me ç'rast është deklaruar në mënyrë decidive se nuk dëshiron të angazhohet mbrojtës, me ç'rast bënë edhe pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e akuzës ndërsa gjykata ka marrë vendimin ku është aprovuar pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit.

Nga të theksuara më lart e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.62/2016 datë 30 mars 2016

Procesmbajtëse,  
Minire Xhambazi

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa